



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0494

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.N.P. "Hysnia", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te katërt" me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1, me 07/11/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet pjesërisht**, si e bazuar ankesa e OE N.N.P. "Hysnia" me nr. 2023/0494, e datës 17/07/2023, vendimi i AK Komuna e Vushtrrisë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te katërt" me numër të prokurimit VU644-22-8608-5-2-1 anulohet, ndërsa lënda kthehet në rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik N.N.P. "Hysnia"

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Komuna e Vushtrrisë nga cilësia e saj si AK ka rivlerësuar aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja e rrugëve te rendit te katërt" me nr. të prokurimit: "VU644-22-8608-5-2-1", ku platformën elektronike me datën 26.06.2023 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës duke rekomanduar për kontratë OE N.N.P "Wenda".

I pakënaqur me vendimin e AK-së me datën 03.07.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE "Hysnia" cilën me datën 07. 07. 2023 AK e ka refuzuar.

Me datë 17.07.2023, OE "Hysnia" ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0494 (numër protokolli).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 01.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

a). Pretendimet e Ankuesit dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues

Sqarim hyrës: Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, më herët në OSHP kanë qenë të parashtruara dy ankesa nga dy OE, ankesa 87/23 nga OE tani prapë ankues "Hysnia", dhe ankesa 102/23 nga OE tani i rekomanduar për kontratë "Wenda". Me vendimin 87/23 dhe 102/23, OSHP në atë kohë pat aprovuar të dy ankesat e OE-ve ankues. OE i rekomanduar Wenda ka çmim më të ulët se OE tani ankues, mirëpo pretendimet e OE ankues janë se Wenda nuk plotëson kërkesat për pajisje/makineri. Vlen të theksohet se nga 4 pajisjet e kontestuara nga OE ankues, për tri nga ato pajisje kane qenë objekt i shqyrtimit me vendimin 102/23. Andaj me qëllim të sqarimit të rrethanave dhe fakteve pretendimet ankimore do i ndajmë në dy grupe.

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimore është se OE i rekomanduar për kontratë Wenda, nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht për: Greder, cilindër, bager dhe bulodzer.

Sqarojmë se me vendimin e OSHP-së nr.102/23, eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues kanë vlerësuar se OE "Wenda" përmes ankesës në OSHP dhe sqarimeve të ofruara shtesë sa i përket Cilindrit, bagerit dhe buldozerit i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit duke aprovuar ankesën e OE tani të rekomanduar për kontratë, andaj konsiderojmë se kjo është çështje e gjykuar.

Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë ankimore është se OE i rekomanduar për kontratë, lidhur me kërkesën për Greder, ku është kërkuar 12 ton, OE i rekomanduar ka ofruar pajisjen në fjalë prej 9.7 ton.

OE ankues dëshmi ka ofruar edhe dudin dogranor ku figuron pesha e pajisjes 9.7 ton.

Parimisht pajtohem me konstatimin e OE ankues se grejderi i ofruar është jashtë paramasve të caktuara nga AK, megjithatë duhet të shtojmë se bazuar në praktikat dhe vendime të mëparshme

të OSHP-së, dallimi në peshë i pajisjeve është lënë në diskrecion të AK-ve (njësisë kërkuese) të vlerësojnë nëse ato pajisje paraqesin pengesa për kryerjen e punëve të parashikuara nga AK. Bazuar në këto që u cekën si më lart vlerësojmë se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar dhe rekomandojmë që me rastin e rivlerësimit AK të kërkoj konfirmim nga njësia kërkuese nëse pajisja e ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë paraqet pengesë për realizimin e kontratës apo e njëjta mund të konsiderohet si devijim i vogël konform nenit 59 par.4 të LPP-së.

Konstatohet në vijim, se raporti i cituar si më sipër është pranuar nga të gjitha palët, me ç' rast AK ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues ndërsa OE nuk është pajtuar.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësia e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin shqyrtues dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues detyrojnë Panelin që aktiviteti i prokurimit në këtë rast t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit për ti përmbushur qëllimet parësore të LPP, sikurse sanksionohen ato me nenin 1, të Ligjit të cituar si dhe lidhur me raportin e ekspertizës duke vlerësuar rrethanat dhe argumentet e paraqitura nga palët paneli nuk ka arritur të gjejë mbështetje të plotë në raport si shkak i shtjellimeve të mëposhtme.

Vlen të theksohet se lidhur me këtë aktivitet në të kaluarën janë paraqitur dy ankesa, ato me nr 87/23 si dhe 102/23, të paraqitura nga tanimë OE ankues si dhe OE i rekomanduar për kontratë, që të dy OE-të ishin eliminuar nga ana e AK-së, ndërsa në vendimet paraprake konform ekspertizave ankesat ishin aprovuar ndërsa lënda ishte kthyer në rivlerësim ku më pas është rekomanduar për kontratë OE me çmimin më të lirë, andaj lidhur me raportin e ekspertit i cili ka deklaruar se çështjet lidhur me tri pajisjet për të cilat janë ngritur pretendime ankimore në këtë ankesë janë çështje të gjykuara, nga ana e panelit lidhur me të njejtat është evidentuar se përmbajnë dallime në aspektin e pretendimeve të ngritura në ankesën e kaluar në relacion me ankesën relevante për shkak se pretendimet qëndrojnë në kontestimin e specifika teknike e poashtu në vendimin paraprak AK është udhëzuar që të kërkojë sqarime shtesë duke aplikuar dispozitat e referuara dhe vendimi konform ekspertizës i nxjerrë nuk ka përmbajtur vendim meritore, kështu që rrjedhimisht paneli ka evidentuar se sqarimet për të cilat janë lejuar që të bëhen me vendimin paraprak janë ndërmarrë nga ana e AK-së, ndërsa dokumentacioni i ofruar në bazë të sqarimeve të ofruara tanimë është kontestuar nga ana e OE ankues, kështu që paneli në këtë rast nuk ka gjetur mbështetje në raportin e ekspertizës mbi pikën ku i njejt ka deklaruar që :

“Sqarojmë se me vendimin e OSHP-së nr.102/23, eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues kanë vlerësuar se OE “Wenda” përmes ankesës në OSHP dhe sqarimeve të ofruara shtesë sa i përket Cilindrit, bagerit dhe buldozerit i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit duke aprovuar ankesën e OE tani të rekomanduar për kontratë, andaj konsiderojmë se kjo është çështje e gjykuar.

Andaj lidhur me pretendimet e lartcekura, të njejtat nga ana e panelit konsiderohen si çështje të pagjykuara për faktin se vendimi paraprak ka përmbajtur udhëzime që përgjatë rivlerësimit të kërkohen sqarime lidhur me pajisjet e njejtat.

Lidhur me këto çështje, paneli konsideron se poashtu në mungesë të përgjigjeve konkrete nga ana e AK në kërkesën për rishqyrtim konform nenit 108/a të LPP-së, për me tepër edhe ligji i procedurës administrative, konkretisht Neni 48 i LPPA-së, parasheh se: "1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ". në rastin konkret paneli konsideron se arsyetimi nuk ka përmbajtur këto dispozita të nenit relevant: 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; andaj në këtë rast konsiderohet se aplikohet pika: 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij, andaj me qenë se kemi të bëjmë me çështje të pagjykuara, obligohet AK që përgjatë rivlerësimit të vërtetojë gjendjen faktike në relacion me pretendimet e ngritura në këtë ankesë, për më tepër ku OE në ankesën e tij ka pretenduar lidhur me mungesën e dokumentacionit lidhur me pajisjet si në vijim:

1. (1) grejder rrafshues min. 12 ton,
2. (1) Cilinder vibrues min. (12-16) ton,
3. (1) Bullduzher per rrafshimin e terrenit minimum 8 ton,
4. (1) eskavator (bager) me peshe (20-30)ton

Lidhur me pikën 1, paneli mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues i cili në bazë të dokumentacionit ka evidentuar gjendjen reale që pajisja relevante devijon nga kërkesat e caktuara, megjithatë aplikimi i devijimeve të vogla siç përcakton edhe legjislacioni në fuqi,

konkretisht neni 59.4 i LPP-së përgjegjësinë e ja atribuon AK-së, ku në bazë të kërkesave dhe nevojave duke u bazuar në këtë nen mund të konsiderojnë një devijim të vogël, andaj mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të AK-së aplikimi i kësaj norme, ashtu siç e përcaktohet nga dispozita e referuar.

Lidhur me pikat 2, 3 dhe 4, ku OE ankues ka pretenduar se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kërkesat e caktuara, me ç'rast dokumentacioni i ofruar nga ana e OE të rekomanduar me anë të sqarimeve i njëjti ka pretenduar se OE i rekomanduar ka ofruar pajisje që nuk paraqiten në listë të pajisjeve në ofertë si dhe marrëveshje të cilat kanë mundur të bëhen pas dorëzimit të ofertave e poashtu pretendime se pajisjet nuk plotësojnë kriteret në aspektin funksional të kërkuar, lidhur me këtë me qenë se aktiviteti kthehet në rivlerësim dhe duke u nisur nga fakti se AK në kërkesën për rishqyrtim nuk ka dhënë përgjigje konkrete se si është vlerësuar oferta e OE të rekomanduar në aspektin e përmbushjes së kriterit, obligohet që përgjatë rivlerësimit të vlerësojë ofertat konform pretendimeve ankimore si dhe në harmoni me dispozitat e LPP-së që rregullojnë çështjet siç janë sigurimi i informatave, dokumenteve dhe sqarimeve shtesë.

Lidhur me pretendimet e paraqitura për pajisjet e listuara si më lartë me nr rendor 2, 3 dhe 4, nga ana e panelit është evidentuar se OE i rekomanduar ka paraqitur dokumentacione shtesë me të cilat AK i ka konsideruar si të pranueshme, por gjithashtu vlen të theksohet se është lehtë e evidentueshme që pajisjet e ofruara përmbajnë tip tjetër pajisje, megjithatë sipas panelit edhe pretendimet se OE i rekomanduar ka paraqitur pajisje të cilat nuk kanë ekzistuar në ofertë nuk qëndrojnë në tërësi për faktin se OE i rekomanduar në ofertën e tij ka prezantuar një listë të pajisjeve e cila në përmbajtje liston 42 pajisje, ndërsa mund të evidentohet se ka pajisje të cilat përmbajnë lloje të përafërta pajisjesh por mund të identifikohen me emrin e tipit, vitin e prodhimit por edhe specifika tjera të vendosura në listë (si psh tek cilindrat, eskavatorët/bagerët dhe buldozherët), që me paraqitjen e dokumentacionin shtesë kanë koiciduar me pajisjet në listë.

Andaj përfundimisht duke u bazuar në të gjitha që u thanë si më sipër, paneli ka arritur në vendim-marrjen sikurse në dispozitiv që zgjidhja me e duhur është konsideruar rivlerësimi i ofertave, andaj obligohet që AK që përgjatë procesit të rivlerësimit me anë të formimit të komisionit profesional të vlerësojë çështjet e ngritura si më sipër dhe duke u bazuar në konstatimet e komisionit të dalë me raport të arsyetuar, poashtu paneli udhëzon AK-në që gjatë procedurave të vlerësimit të ketë parasysh aplikimin e qartë të dispozitave të neneve 59 si dhe 72 të LPP-së, që në rastin konkret duke zbërthyer paragrafët 1 dhe 3 të LPP-së të cilët lejojnë sqarimet dhe plotësimin e dokumentacionit, por me kusht që ai *“...do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”* kjo ndërlidhet me aplikimin e paragrafit 2 të nenit 59 të LPP i cili saktëson se lidhur me sqarimet e ofruara *“...Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.”* Kështu që paneli konstaton se në rastin konkret përgjatë rivlerësimit, me aplikimin e normave të referuara mund të kuptohet se sqarimet lidhur dëshmitë dhe dokumentacionet me pajisjet e paraqitura në listë mund të kërkohen me kushtin që ato të janë të njëjtat sikurse në listën e prezantuar dhe të kenë lidhshmëri në të kundërtën dorëzimi i pajisjeve shtesë (të pa-paraqitura në listë) konsiderohet si ndryshim material si dhe sa i përket vërtetimit të faktit që të dokumentet e paraqitura janë konform legjislacionit që referohet që *“vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.”* që në rastin konkret OE ankues ka pretenduar se marrëveshjet mbi qeranë e pajisjeve nuk përmbushin këtë normë, këtë

autoriteti mund ta verifikojë konform neneve të referuara duke kërkuar noterizimin e tyre, që do të vërtetonte ekzistimin e dokumentit para dorëzimit të tenderit. Të gjitha këto udhëzime janë dhënë duke u bazuar në rastet e ngjashme të deritanishme me situatë të ngjashme që nënkupton konsistencën me vendimet paraprahe.

Ndërsa çështjet mbi aplikimin e informatave shtesë, sqarimin e tenderëve si dhe terminologjinë e pajisjeve, këto çështje konsiderohen se janë tanimë çështje të gjykuara me vendimet paraprahe në të cilat i ju është falur mendimi ekspertit shqyrtues.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - N.N.P. "HYSNIA"**
- Arkivës së OSHP-së: